



# Buletini Mjedisor

## QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR PYJET DHE KULLOTAT



Këshilli i Ministrave miratoi më 25 nëntor 2015 projektligjin e

hartuar nga Ministria e Mjedisit, "Për administrimin e fondit pyjor dhe kulloror kombëtar në Republikën e Shqipërisë". Nëse Kuvendi e miraton këtë projektligji me shumicë votash, më 1 janar 2016 pritet të fillojë moratoriumi 10-vjeçar i pyjeve.

Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, në një konferencë për shtyp të zhvilluar po në të njëjtën ditë, e konsideroi kalimin e këtij projektligji nga Qeveria, "Si një vendim historik, i cili i hap rrugë një nisme ligjore shumë të rëndësishme dhe njëres prej reformave më jetike në fushën e pyjeve dhe kullotave për vendin tonë. Në këtë projektligji, që presim të kalojë në Kuvend, krahas moratoriumit 10-vjeçar i jepet zgjidhje ngërçit të krijuar me fondin pyjor, duke zgjidhur përfundimisht kalimin e menaxhimit 100% të pyjeve në Bashkitë e vendit".

Pritet që kjo reformë madhore, në sektorin e pyjeve, të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në funksion të rritjes së cilësorisë së jetës dhe mirëqenies së qytetarëve shqiptarë, në interes të shoqërisë së sotme dhe të nesërme.

### ÇFARË DO TË SJELLË LIGJI I RI I PYJEVE?

Ligji është organizuar në 18 krerë, të cilët shpjegojnë reformën e rëndësishme që do ndërmerret në drejtim të organizimit dhe menaxhimit të fondit pyjor e kulloror kombëtar. Kështu, në kreun III, "Funksionet, përbërja, pronësia dhe administrimi i fondit pyjor dhe kulloror", përcaktohen funksionet ekologjike, ekonomike dhe

sociale që përbushin pyjet dhe kullotat si ekosisteme komplekse. Klasifikimi i pyjeve, në varësi të qëllimit të tyre, bëhet në pyje prodhues, mbrojtës dhe të mbrojtur. Klasifikimi i kullotave bëhet sipas kriterëve të posaçmë në kullota verore dhe kullota dimërore, ndërsa pyjet, kullotat dhe livadhet në territorin e Republikës së Shqipërisë si pasuri kombëtare klasifikohen në: fond pyjor dhe kulloror në pronësi publike dhe pronë e paluajtshme e njësisë së qeverisjes vendore për sipërfaqet brenda kufijve territorial administrativë;

-Fondi pyjor dhe kulloror në pronësi publike, pronë e paluajtshme e ministrisë, që është pjesë e rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Republikës së Shqipërisë;

- Fond pyjor dhe kulloror në pronësi private të personave fizikë/juridikë.

Njësitë e qeverisjes vendore ngarkohen me ligji të ngrenë strukturën përkatëse përgjegjëse për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kulloror, brenda kufijve territorial administrativë me personel inxhinieroteknik me arsim pyjor. Në këtë kre përcaktohen edhe kriteret teknike për rekrutimin e nëpunësve në funksion të sipërfaqes: një nëpunës për 750 – 1000 ha për pyjet e lartë; një nëpunës për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulët dhe shkurre; një nëpunës për 4000 – 6000 ha për kullota dhe livadhe.

Një pikë e rëndësishme e projektligjit është Kreu XIV "Financimet", i cili përcakton se financimet e nevojshme për administrimin, qeverisjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kulloror sigurohen nga buxheti i shtetit, burimet e brendshme dhe donacionet e grantet e ndryshme. Ministria dhe njësitë e

qeverisjes vendore i përdorin financimet për investime të ndryshme në pyje e kullota, për administrimin, trajtimin dhe zhvillimin e tyre, mbrojtjen e faunës së egër, mjedisit dhe biodiversitetit, mbarëshkrimin, inventarizimin dhe monitorimin e pyjeve dhe kullotave; parandalimin dhe lufimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve; mbështetjen e njësisë të qeverisjes vendore dhe pronarëve privatë; studime, projekte e kërkime shkencore; punimet e mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të gjendjes së pyjeve dhe kullotave; shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e veprave të ujit të pijshëm për blegtorinë dhe infrastrukturën rrugore.

Kreu XVII, "Kundërvajtjet në pyje dhe kullota", parashikon shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative në fondin pyjor dhe kulloror kombëtar dhe në varësi të pasojave të lehta apo të rënda, përcakton vlerën përkatëse të ndëshkimit me gjobë. Krahas ndëshkimit me gjobë, ligji përcakton dhe dënimet plotësuese: sekuestrimin e mjeteve dhe automjeteve që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes dhe sekuestrimin në vlerë monetare dhe materiale, lëndë drusore dhe jodrusore, bimë medicinale, florë dhe faunë të përfutur nëpërmjet kundërvajtjes; pezullimin e veprimtarisë dhe çmontimin e instalimeve. Të drejtën e procedimit administrativ, ligji ia jep Inspektoriatit të Policisë Pyjore, ndërsa kryerja e vlerësimit të dëmit të shikuar është detyrë e inspektoriatit dhe shërbimit pyjor të njësisë së qeverisjes vendore. Ajo çfarë pritet nga ky projektligji, është zhdukja e copëtimit dhe fragmentimit të deritanishëm që i është bërë pyjeve duke krijuar një fond unik kombëtar, i njohur në ligji, si Fondi Pyjor e Kulloror Publik.

## PËRFUNDON VENDEDEPOZITIMI I MBETJEVE TË ELBASANIT



Vetëm disa muaj pas fillimit të punimeve, është përfunduar më 16 nëntor 2015 venddepozitimi sanitar i Elbasanit, pjesë e projektit të impiantit termik për trajtimin e mbetjeve urbane dhe industriale.

Të pranishëm në këtë pëdurim ishin Kryeministri i vendit, z. Edi Rama, Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, kryebashkiaku i Elbasanit z. Qazim Sejdiu dhe deputetë të zonës. Të shoqëruar nga drejtuesit e punimeve, u inspektuan punimet e kryera të njërit prej projekteve më të mëdha në fushën e mjedisit, i pari i këtij lloji në vend i realizuar sipas standardeve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian. Teknologjia dhe kushtet e ndërtimit të këtij vend-depozitimi sanitar të mbetjeve në qytetin e Elbasanit kanë respektuar standardet e Bashkimit Evropian.

Në fjalën e tij, Kryeministri Rama, u shpreh: "Ja premtuam Elbasanit dhe po e realizojmë brenda mandatit. Ky venddepozitim jo vetëm zgjidh një problem, por faktikisht mundëson kalimin në një fazë komplet tjetër të administrimit të mbetjeve, që nuk e ka asnjë qytet tjetër. Ne jemi në përparim për ta përtërirë këtë eksperiencë edhe në disa zona të tjera, me shpresën e madhe, që në një masë shumë të konsiderueshme, ky problem do të zgjidhet me themel, një herë e mirë, dhe Shqipëria nga një vend i mbytur nga plehurat nga të katërta anët, jo vetëm për shkak të mungesës së pikave të depozitimit, por edhe për shkak të helmeve që ato prodhojnë, të shndërrohet në një vend normal në këtë aspekt, siç e meriton faktikisht".

Ministri i Mjedisit, theksoi se ky është një ndër projektet më të rëndësishme në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, që jo vetëm do të sjellë një trajtim të standardeve evropiane, por edhe do të prodhojë energji nga mbetjet.

"Është rasti i parë që nga mbetjet do të përftohet energji me rreth 2.85 mW, nga të cilat 0.5 mW do të jenë për vetë impiantin dhe pjesa tjetër do t'i kalojë Bashkisë së Elbasanit për të mbuluar nevojat e qytetarëve. Ajo që është më e rëndësishme, ndryshe nga venddepozitimet e tjera, për herë të parë Bashkia e Elbasanit për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve e ka koston zero" - tha Ministri Koka.

Venddepozitimi ka një sipërfaqe prej 21 mijë m2 dhe një kapacitet përpunues maksimal 360 mijë metër kub. Paralelisht me ndërtimin e tij ka filluar edhe zhvendosja e mbetjeve nga venddepozitimi aktual, i cili brenda katër muajve do të mbyllet. Me kapulimin e vendndodhjes aktuale të mbetjeve dhe përfundimin e inceneratorit, qarku i Elbasanit shndërrohet nga qarku më problematik për ndotjet mjedisore, në një histori suksesi mjedisor për këto 2 dekadat e fundit.

### NË KËTË NUMËR:

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR PYJET DHE KULLOTAT - FQ 1

PREZANTOHEN PROGRAMI STRATEGJIK I ZONAVE TË MBROJTURA - FQ2

TRAJNOHEN DREJTORITË RAJONALE TË MJEDISIT DHE PUSHTETI VENDOR MBI PROCESIN - FQ 3

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE - FQ5

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësorisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkëvenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".



## REZULTATET E KONTROLLIT TË SUBJEKTEVE MINERARE PËR QARKUN E KUKËSIT



Një marrëveshje midis Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ka mundësuar kontrollin e

subjekteve minerare në qarkun e Kukësit. Rezultatet e inspektimit u prezantuan në një konferencë për shtyp nga drejtuesit e dy institucioneve, z. Ergys Agasi dhe z. Dael Dervishi.

Kryespektori, Ergys Agasi, tha: "Aktiviteti i nxjerrjes së mineralit të kromit është një nga aktivitetet me impakt të konsiderueshëm në dëmtimin e mjedisit dhe të pyjeve, ndaj ISHMP ka filluar këtë inspektim që do të vijojë gjatë gjithë muajt dhjetor, ku asnjë shkelje nuk do të tolerohet".

Ndërsa në fjalën e tij, kreu i AKBN-së z. Dervishi u shpreh: "Kemi mbështetur ISHMP-në në këtë aksion të qarkut Kukës me gjithë kapacitetet tona njerëzore dhe logjistike. Kemi vënë në dispozicion databazën e plotë të subjekteve minerare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun Kukës, specialistët tanë kanë shoqëruar inspektorët e ISHMP-së në këto kontrolle".

Nga rezultatet e inspektimit të 41 subjekteve nga ana e **Inspektoriatit të Pyjeve** në subjektet minerare në qarkun Kukës vihet re se:

Tre nga këto subjekte kanë bërë heqjen nga fondi pyjor për sipërfaqen 12.3 Ha, me dokumentacion të rregullt. Këto sipërfaqe kanë kaluar në varësi të Ministrisë së Energjisë dhe

Industrië.

Tre nga këto subjekte kanë marrë me qira nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor me dokumentacion të rregullt, një sipërfaqe prej 3.08 ha.

Në 10 nga këto subjekte është hasur shkelje nga kontrolli i ushtruar. Këto 10 subjekte kanë aplikuar për heqjen nga fondi pranë Ministrisë së Mjedisit, por kanë ndërhyrë abuzivisht në pyje, pa marrë miratimin sipas ligjit në fuqi. Sipas kontrollit të ushtruar, ndërhyrja ka rezultuar të jetë në një sipërfaqe prej 31.3 ha, duke shkaktuar dëmtim të fondit pyjor e atë të kullotave, në vlerën rreth 14 miliardë e 89 milionë lekë.

Nga këto inspektime është kërkuar të procedohen penalisht 3 nga këto subjekte, të cilat nuk kanë qenë të pajsur me leje mjedisore, që jepet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ose kanë pasur parrugullsi në dokumentacionin e lejeve minerare, duke i shkaktuar dëme fondit pyjor të zonës, në vlerën rreth 464 milionë lekë.

Gjithashtu, janë vendosur gjoba administrative, për 2 nga subjektet minerare. Nga kontrolli i ushtruar, ka dalë që këto subjekte kanë vënë në funksion përdorimi disa shtylla në minierë, ose thënë ndryshe kolonat mbështetëse në galerinë e minierave, janë vënë pa dokumentacionin që ligji kërkon, si dhe pa lejet përkatëse.

Më tej, 2 nga subjektet, kanë rezultuar se nuk kanë aplikuar për heqje nga fondi pyjor, duke vazhduar përdorimin abuziv të

pyjeve në një sipërfaqe prej 6.24 ha me vlerë dëmi 2 miliardë e 808 milion lekë. Rreth 11 subjekte nuk ushtrojnë më aktivitetin e tyre.

Për 5 subjektet abuzive është propozuar kërkesë për revokim të lejeve minerare, pranë AKBN-së. Arsyet janë shkelje të përsëritura nga këto biznese, mungesë dokumentacioni, mosrespektim procedurash, si dhe dëm në fondin pyjor dhe në mjedis.

Gjatë kontrollit për ndikimin e këtyre aktivitetëve në fushën e pyjeve, u kontrolluan këto subjekte nga **Inspektoriatit i Mjedisit**, i cili kishte në fokus të kontrollit lejet mjedisore, kushtet e vëna dhe zbatueshmërinë e këtyre kushteve gjatë ushtrimit të aktivitetit në 36 subjekte. Nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se kanë pasur mungesa të lejeve mjedisore ose ka munguar respektimi i kushteve të lejeve mjedisore. Janë vendosur gjoba në 5 subjekte në vlerë totale prej 2.5 milionë lekë.

Pasi prezantoi të dhënat e inspektimit, kryespektori Agasi, theksoi se inspektimi do të vijojë javën e ardhshme në Bulqizë. "Dua t'ju informoj se në ditët në vijim, grupet tona fillojnë ushtrimin e kontrolleve në Bulqizë. Me këtë rast do të doja të bëja një thirrje për gjithë subjektet që të zbatojnë ligjin. Shkatërrimi i mjedisit është shkatërrimi i së ardhmes sonë. Inspektoriatit në asnjë rast nuk ka qëllim në vetvete ndëshkimin e biznesit. Ne jemi rojtaret dhe mbrojtësit e mjedisit, jemi rojtaret dhe mbrojtësit e shëndetit të qytetarëve shqiptarë".

## TRAJNOHEN DREJTORITË RAJONALE TË MJEDISIT DHE PUSHTETI VENDOR MBI PROCESIN E VNM-SË DHE LEJEVE



Në javën e tretë të nëntorit 2015, Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian TAIEX-ECRAN, zhvilloi dy trajnime dy-ditore në hotelin Doro, Tiranë. Këto trajnime u zhvilluan me përfaqësuesit e Drejtorive Rajonale të Mjedisit dhe përfaqësuesit e pushtetit vendor në lidhje me legjislacionin Evropian, legjislacionin kombëtar të procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe procesit të Lejeve Mjedisore. Gjithashtu, në këtë trajnim u trajtuan dhe tematikat që lindin gjatë zbatueshmërisë së këtij legjislacioni në punën e përditshme.

Takimi i datës 16 - 17 nëntor 2015, u zhvillua me përfaqësuesit e Drejtorive Rajonale të Mjedisit të qarqeve të Elbasanit, Fierit, Beratit, Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Në këtë takim kishte dhe prezencë të përfaqësuesve të këtyre bashkive. Gjatë seancës së parë u prezantua Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duke bërë dallimet përkatëse mes këtyre dy proceseve. Gjithashtu, u prezantua dhe Direktiva e Ndotjeve Industriale, pjesë e së cilës është procesi i lejeve të mjedisit të Tipit A, B dhe C. Këto prezantime u mbajtën nga ekspertët e TAIEX, z. Klemen Strmšnik (ECRAN

NKE), Matthew Cashmore (TAIEX expert).

Pas prezantimit të legjislacionit evropian, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, z. Redi Baduni, Drejtori i Mjedisit dhe znj. Ornela Shoshi, përgjegjëse e sektorit të VNM-së, VSM-së dhe Ndotjes Industriale dhe Standardeve Mjedisore, i njohën të pranishmit me legjislacionin kombëtar dhe më konkretisht me ligjin Nr. 10440/2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"(VNM), të ndryshuar me aktet nënligjore, që rrjedhin prej tij, si dhe ligjin Nr. 10448/2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, e aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

Gjatë pasdites u prezantua nga znj. Edlira Dersha, specialiste e komunikimit në sektorin e Transparencës dhe Komunikimit, se si duhet të organizohet "Konsultimi i palëve të interesuara në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në procesin e Lejeve Mjedisore të tipit A, B dhe C".

Në këtë prezantim, të pranishmit u njohën jo vetëm me legjislacionin që mundëson informimin e publikut dhe tërheqjen e mendimit të tij në vendimarrjen mjedisore, por u shpjegua dhe niveli i përfshirjes së publikut në VNM-në jo të thelluar dhe të thelluar, si edhe procesin e përfshirjes së publikut gjatë procesit të procedimit për lejet e mjedisit të tipit A

dhe B. Gjithashtu, pjesë e prezantimit ishin dhe teknikat që duhen përdorur për organizimin e dëgjësive të publikut, si dhe roli i çdo aktori që merr pjesë në këtë proces.

Ky takim u ripërsërit dhe në datën 19-20 dhjetor me përfaqësuesit e Drejtorive Rajonale të Tiranës, Durrësit, Dibrës, Lezhës, Shkodrës dhe Kukësit.

Gjatë dy trajnimeve dy-ditore, përfaqësuesit e Drejtorive Rajonale të Mjedisit ishin mjaft aktivë duke sjellë shembuj konkrete nga puna e tyre në terren. Gjatë gjithë paqartësive apo problematikave të hasura, ekspertët e huaj sillnin shembuj nga vendet e rajonit si Sllovenia dhe Serbia, se si ishte legjislacioni apo praktika në kushte të ngjashme.

Gjatë trajnimit u vu re se kërkohej një bashkëpunim më i mirë me pushtetin vendor, pasi legjislacioni mjedisor në fushën e VNM-së dhe Lejeve Mjedisore kërkon një bashkëpunim me vendimarrjen lokale, për më tepër kjo nevojë ka dalë më shumë në pah pas hyrjes në fuqi në verën e 2014 të ligjit për "Ndarjen administrativo - territoriale të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

## VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS TETOR 2015

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Tetë Albania	VP Minierë bakri	Spac, Mirditë	Vendim për VNM Paraprake
2	Hydro Seta	VP HEC	Arras, Dibër	Kërkesë për plotësim informacioni
3	AB COM	VP Infrastrukturë kabllore	Berat	Vendim për VNM Paraprake
4	Allbenia Ferro	VTH Shfrytëzim kuarci	Kërnajë, Tropojë	Kërkesë për plotësim informacioni
5	Tur Alb Krom	VTH Shfrytëzim kromi	660/5, Kalimash, Kukës	Deklaratë Mjedisore
6	Tur Alb Krom	VTH Shfrytëzim kromi	660/6, Kalimash, Kukës	Deklaratë Mjedisore

## LEJET MJEDISORE SHTATOR 2015

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1	Pastrime Silvio	Transportim dhe grumbullim i mbetjeve urbane	Bashkia Peqin, Elbasan	Miratim	Tipi B
2	Coevita	Ndryshim	Elbasan	Miratim	Tipi B
3	Betonplus Company	Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimin i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Komuna Shënkoll, Lezhë	Miratim	Tipi B
4	AGROTEK ALB	Rritje intensive e shpendëve në një instalim	Krujë, Durrës	Miratim	Tipi B
5	Vëllezërit Hysa	Distilim i katanit ose i bitumit në lidhje me ndonjë proces prodhimi	Klos Elbasan	Miratim	Tipi B
6	TEKI	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Bulqizë, Dibër	Miratim	Tipi B
7	Limak Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim	III.2.B. Transportim i gomave të përdorura	Komuna Klos, Elbasan	Refuzim	Tipi B
8	Xh.F.Kacos	III.2.B Grumbullim dhe transportim të mbetjeve metalike prej hekuri dhe çeliku dhe atyre me ngjyrë (skrap) për qëllime riciklimi	Korçë	Refuzim	Tipi B

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1	Almarina Or	Rritje intensive e peshqve	Karaburun-Orikum	Miratim	Tipi B
2	Artemis Farm	III.2.B Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme	Vaqarr, Tiranë	Refuzim	Tipi B
3	Limak Insaat (Lc-3341)	Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit	Moglicë, Korçë	Refuzim	Tipi B
4	Limak Insaat (Lc-3422)	Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit	Moglicë, Korçë	Refuzim	Tipi B
5	Lamnica	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to	Tropojë, Kukës	Miratim	Tipi B
6	Frigo Food	Trajtimin dhe përpunimin e materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndet e para nga kafshët	Kashar, Tiranë	Refuzim	Tipi B
7	Kuari Blace	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to	Qukës, Elbasan	Refuzim	Tipi B
8	Deliu-05	Prodhim i gizes ose çelikut duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme. Prodhim i produkteve prej plastikës	Kashar, Tiranë	Refuzim	Tipi B
9	K.I.D -Alb (Lc-3965)	Nxjerrja e mineraleve të rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Mamina, Durrës	Refuzim	Tipi B

### ZHVILLOHEN ORËT E HAPURA NË QARKUN E GJIROKASTRËS



Në javën e dytë të nëntorit, orët e hapura të edukimit mjedisor u zhvilluan në prefekturën e Gjirokastrës.

Gjatë këtyre katër ditëve rreth 912 fëmijë u njohën me problemet mjedisore, të cilat janë të pranishme në jetën tonë të përditshme, në qytete, fshatra, lumenj, liqene e pyje, përfshirë dhe zonat e mbrojtura.

Orët e hapura u zhvilluan në shkollat nëntëvjeçare të qyteteve të

Gjirokastrës, Përmetit, Këlcyrës, Tepelenës, Malmajit dhe Fierit. Në këto orë mjedisore u dhanë shembuj konkret të sjelljeve që duhen përvetësuar nga nxënësit dhe duhen vënë në jetë në funksion të mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit ku ne të gjithë jetojmë.

Gjatë orëve të hapura metoda e ndjekur nga stafi i Ministrisë së Mjedisit është interaktive, ku nxënësi nuk është vetëm dëgjues, por luan një rol aktiv në

zhvillimin e orës së mësimi duke treguar sjelljet e tij të përditshme apo shqetësimet që ka për mjedisin që e rrethon.

Gjithashtu, fundi i orës së hapur përmban një prezantim mbi monumentet e natyrës që ka çdo qytet, ku zhvillohet ora e mësimi. Në këtë pjesë vihet re një entuziazëm nga ana e fëmijëve për zonat e bukura që ata kanë pranë qytetit, ku jetojnë dhe mësojnë.



### DËGJESAT E PUBLIKUT NË MUAJIN NËNTOR

**P**rogres Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë, i vitit 2015, ka bërë një vlerësim pozitiv për punën e Ministrisë së Mjedisit në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe transparencës në vendimarrje. “Konsultimi me publikun, qasja në informacion dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile janë përmirësuar”. (Progres Raporti 2015, 4.27. Kapitulli për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, fq. 67).

Në këtë kontekst, edhe gjatë muajit nëntor kanë vijuar dëgjesat me publikun për aktet ligjore që ministria ka në proces hartimi apo konsultimi.

Ministria e Mjedisit, më 12.11.2015, në sallën e mbledhjeve në ministri, organizoi dëgjesën publike për *draft* Vendimin e Këshillit të Ministrave për **“Importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme”**.

Ky *draft*-Vendim synon të përcaktojë:

- (i) Masat administrative dhe teknike për t'u zbatuar nga Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, eksportuesit dhe importuesit, me qëllim zbatimin e Konventës së Roterdamit mbi: (i) Procedurën e Informimit të Pëlqimit Paraprak (PIC) për disa kimikate të rrezikshme dhe pesticide në Tregtinë Ndërkombëtare; (ii) Procedurën e Njoftimit të Eksportit të kimikateve të rrezikshme midis Palëve dhe çdo shteti tjetër.
- (iv) Listën e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm, subjekt i njoftimit të eksportit;
- (v) Listën e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm subjekt i Procedurës së Informimit të Pëlqimit Paraprak (PIC); (vi) Listën e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm që ndalohen të eksportohen. Gjatë takimit, pati komente mbi *draft*in nga pjesëmarrësit në takim dhe u dhanë shpjegimet nga znj. Laureta Dibra, përgjegjëse e sektorit të Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike. Pati edhe sugjerime, të cilat do reflektohen në *draft*in e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Ditën e martë, datë 17.11.2015, u organizua në sallën e mbledhjes së Ministrisë së Mjedisit, dëgjesa e publikut për *draft* Vendimin e Këshillit të Ministrave për **“Listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (svhc), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e svhc dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të svhc”**.

Ky vendim do të përcaktojë: (i) Listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC); (ii) Kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC; (iii) Kushtet e dhënies së një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC.

Në këtë takim pati prezencë të ekspertëve nga organizatat mjedisore të cilët dhanë komentet e tyre për *draft*in, të cilat u morën parasysh nga stafi i ministrisë që ka punuar në hartimin e këtij *draft*-Vendimi të Këshillit të Ministrave.



Ekspozita nga fëmijët e Divjakës me temë: "Mjedisi"

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT  
Email: info@moe.gov.al

## NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE

### PREZANTOHET STUDIUMI PËR CILËSINË E AJRIT NË AMBIENTET E BRËNDSHME TË SHKOLLAVE



Ditën e martë, 24 Nëntor 2015, në ambientet e shkollës nëntëvjeçare "Edith Durham", në Tiranë, përfaqësues të Qendrës Rajonale të Mjedisit në Shqipëri (REC) prezantuan para mësuesve të kësaj shkolle disa gjetje të monitorimit të cilësisë së ajrit të brendshëm të 114 shkollave fillore në 23 vende të Evropës. Pjesë e këtij studimi ishin dhe monitorimi i ajrit të brendshëm në 10 shkolla të Shqipërisë, ku kjo shkollë kishte qenë pjesë e studimit.

Mjedisi i brendshëm në shkollë përbën një shqetësim të veçantë, pasi nxënësit janë një grup veçanërisht i rrezikuar i popullsisë. Në Evropë, më shumë se 64 milionë nxënësit dhe rreth 4,5 milionë mësues qëndrojnë për shumë orë, çdo ditë, në mjediset e brendshme të shkollave të arsimit parashkollor, fillor apo të mesëm.

Përveç shtëpisë, fëmijët shpenzojnë më shumë kohë në shkollë sesa në çdo vend tjetër. Ka shumë prova për ndikimin e mundshëm negativ të shumë ndotësve në shëndet, që gjenden në ajrin e brendshëm në shkollë, si pjesë e këtij ajri apo të lëshuara nga materialet dhe produktet që ndodhen në këto mjedise të mbyllura, apo që prodhohen nga aktivitetet që zhvillohen në mjediset e brendshme të shkollës. Prania e ndotësve në shkolla ndikon në rritjen e fëmijëve, arritjet dhe mundësitë në procesin e të mësuarit dhe të nxënës, si dhe zhvillimin kulturor dhe social të fëmijëve. Në dekadat e fundit të shekullit të 20-të, në botën e industrializuar, përfshirë edhe Evropën, është dokumentuar shtimi i rasteve të astmës bronkiale [8]. Fëmijët astmatikë janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj efekteve të cilësisë së dobët të ajrit.

Monitorimi i ajrit, të jashtëm/ brendshëm, përfshin të dhënat atmosferike si (temperaturë, lagështirë), monoksidin e karbonit, (CO), dioksidin e karbonit (CO<sub>2</sub>), dioksidin e azotit (NO<sub>2</sub>), benzenin grimçave të PM10.

### NIVELET E EKSPOZIMIT

- ⇒ Vlerat prag për PM2.5 dhe radonin, të rekomanduara nga OBSH, nuk respektohen në shumicën e klasave të monitoruara.
- ⇒ 13% e të gjithë nxënësve janë të ekspozuar ndaj PM2.5 në përqëndrim më të lartë se 25 µg/m<sup>3</sup> (pragu i OBSH-së për mjediset 24 orëshe), dhe më shumë se 85% në përqëndrim mbi 10 µg/m<sup>3</sup> (vlera e mesatares vjetore të OBSH-së), të cilat janë vlerat prag të rekomanduara për

të kufizuar rrezikun e efekteve afatgjata në sistemin respirator-kardiovaskular dhe vdekshmërinë nga kanceri në mushkëri.

- ⇒ 50% e nxënësve janë të ekspozuar ndaj radonit në nivele më të larta se 100 Bq/m<sup>3</sup> (p.sh. referenca kombëtare për banesat, propozuar nga OBSH-ja në 2010-ën me qëllim menaxhimin e rrezikut të shtuar nga kanceri i mushkërive shkaktuar nga radoni). Në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Evropën Jugore vërehen nivele më të larta të vlerave mesatare.
- ⇒ Rreth 25% e të gjithë nxënësve janë të ekspozuar ndaj benzenit në shkollë, në përqëndrime mbi 5 µg /m<sup>3</sup> (Direktiva e Cilësisë së Ajrit 2008/50/EC), vlera prag për menaxhimin e rrezikut të shtuar nga leucemia. Bazuar në vlerësimet e rrezikut për njësi të përcaktuar në udhëzimet e OBSH-së, niveli mesatar i ekspozimit ndaj benzenit është i lidhur me nivelin e rrezikut prej 1.3 x 10<sup>-5</sup>, me një rrezik të shtuar për jetën nga leucemia prej 1:76,923 në totalin e popullsisë së studiuar, dhe një nivel rreziku prej 2.0 x 10<sup>-5</sup>, duke i korresponduar një rreziku të shtuar për jetën nga leucemia prej 1:50,000, tek nxënësit në Evropën Qendrore dhe Lindore.
- ⇒ Më shumë se 60% e të gjithë nxënësve janë të ekspozuar ndaj formaldehidit në shkollë në përqëndrime mbi 10 µg/m<sup>3</sup>, (vlerë e propozuar nga Agjencia Franceze për Sigurinë Mjedisore dhe Shëndetin në Punë, AFSSET, si vlerë prag në terma afatgjatë për ajrin e brendshëm për tu mbrojtur nga efektet afatgjata në funksionimin e mushkërive dhe të rasteve të shtuara me kancer nga formaldehida). Në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Evropën Jugore vërehen nivele më të larta të vlerave mesatare.
- ⇒ Ekspozimi në mjediset me tym duhani është ende i pranishëm në disa shkolla (5%).

Në prezantimin që u bë gjetjeve për Shqipërinë, znj. Daniela Ruci theksoi se monitorimi i të dhënave të cilësisë së ajrit brenda klasave, kishte një nivel të lartë të Dioksidit të Karbonit CO<sub>2</sub>, pasi klasat nuk kanë ventilim, janë të mbipoplluara dhe madje mungon edhe ajrosja mekanike.

Në këtë prezantim u dhanë dhe disa masa konkrete që duhet të

kishin parasysh mësuesit, të cilët janë po aq të rrezikuar sa dhe fëmijët gjatë orëve të gjata të qëndrimit në ambientet e klasës. Këto të dhëna do i përcillen dhe Ministrisë së Arsimit që të mundësojnë marrjen e disa masave që mund të sjellin përmirësimin e cilësisë së ajrit brenda ambienteve të shkollave tona.

### AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR REDUKTIMIN E RREZIKUT NGA KATASTROFAT

Qendra Aarhus Shkodër, ka vijuar takimet ndërgjegjësuere nëpër shkolla, me fëmijët që jetojnë në zonat më të prekura nga katastrofat natyrore në zbatim të projektit, "Përforsimi i kapaciteteve të Qendrës Aarhus për ndërgjegjësimin e komunitetit për reduktimin e rrezikut nga katastrofat", financuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Kështu, në datën 3 nëntor 2015, AIC Shkodra zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësuere me nxënësit e nivelit të lartë të shkollës nëntëvjeçare të shkollës "Liria", në qytetin e Shkodrës, në këtë takim kishte dhe fëmijë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët janë më të prekur, pasi jetojnë pranë bregut të lumit Buna dhe shpatit të Malit të Taraboshit.

Gjithashtu, ata jetojnë në kushte jo të përshtatshme sigurie në banesat e tyre, ndaj ky takim ndërgjegjësuere u vlerësua me shumë interes.

Më 27 nëntor 2015, kjo qendër vazhdoi aktivitetin ndërgjegjësuere për reduktimin e rrezikut nga katastrofat në shkollën e mesme të bashkuar të Gurit të Zi. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe z. Elton Qendro, përfaqësues i prezencës së OSBE-së në Shqipëri, i cili foli për rëndësinë e marrjes së informacioneve të tilla për masat reduktuese dhe mbrojtëse ndaj fenomeneve të emergjencave apo katastrofave, si dhe solli raste konkrete të këtyre fenomeneve nga vende të ndryshme. Ndërsa Qendra Aarhus Shkodër, në formë bashkëpunimi, prezantoi konkretisht masat paraprake dhe masat në rast përballimi të fenomeneve si tërmetet, zjarret dhe përmbytjet. Gjatë diskutimeve, nxënësve dhe studenteve u shpërnda "Libri familja" përgatitur nga OSBE-ja, i cili përmban informacione shumë të vlefshme, jo vetëm për katastrofat e trajtuara gjatë ditës së sotme, por edhe për raste të tjera emergjente.

